

FJALA E DEPUTETIT TONI GOGU

E ENJTE 6 TETOR 2022

Të nderuar kolegë,

Sot ne po kalojmë një marrëveshje midis qeverisë sonë dhe qeverisë japoneze, e cila mundëson ruajtjen, konservimin e së djeshmes. Gjej rastin ta falënderoj përzemërsisht ministren e Kulturës për punën shumë intensive dhe të palodhur që ka bërë, që investimi për të ruajtur të djeshmen të ketë ndihmën e partnerëve dhe të mos jetë një barrë në buxhetin shqiptar. Pra, jemi përkushtuar dhe, tashmë, ka një sërë veprash që tregojnë angazhimin e plotë të kësaj shumice për t'u ballafaquar me të shkuarën, për të mësuar nga e shkuara, për të dëgjuar të shkuarën, për ta ruajtur të shkuarën, për ta konservuar atë dhe për të mësuar për të sotmen dhe për të ardhmen. Sot doja të flisja pak në lidhje me këtë gjë: si do ta mbrojmë të sotmen dhe si do ta mbrojmë të ardhmen?

Të nderuar qytetarë që na ndiqni, ju sot do të dëgjoni dy mesazhe; ju sot do të shikoni që do të ballafaqohen dy programe; ju sot do të dëgjoni kolegë deputetë, të cilët do të veprojnë, do të bëjnë diçka për të ruajtur të sotmen dhe për t'u mbrojtur për të ardhmen, gjithashtu, do të dëgjoni edhe kolegë, të cilët do të vazhdojnë të flasin, të flasin dhe të flasin. Dje Banka e Shqipërisë mori një vendim jashtëzakonisht të rëndësishëm për shoqërinë shqiptare. Secili nga ne është kryefamiljar, është pjesë e familjes, ulet ne tavolinë dhe e ndien fare mirë që shporta e shqiptarit sot po vuan; shporta e ushqimeve të shqiptarit sot po vuan. Janë rritur çmimet bazë; është rritur çmimi i karburantit. Sot ju do të dëgjoni këtu, do të më dëgjoni mua e koleget e mi, do të dëgjoni edhe kolegët e tjerë, të cilët do të shpjegojnë.

Nuk dua të bëj interpretimin tim, por dua t'i referohemi autoritetit kushtetues, të cilin e kemi zgjedhur në këtë parlament të monitorojë çmimet dhe të marrë masat e duhura për të ruajtur stabilitetin e çmimeve. Guvernatori i Bankës së Shqipërisë dje njoftoi se inflacioni i ka gërryer çdo familjeje shqiptare 8% të të ardhurave të saj dhe që ta ndajmë e të sqarohemi se bashku: "Ky inflacion - thonë Banka e Shqipërisë, "Bloombergu", "Reutersi", Banka Qendrore, bankat e

vendeve të tjera, FED-i, banka e Anglisë, - ka dy arsye”. Ju do të dëgjoni këtu 100 arsye të tjera, por jo dy arsyet e vërteta.

Dy arsyet e vërteta pse shportës së çdo shqiptari, tryezës së çdo shqiptari sot mund t'i mungojnë disa gjëra apo që secili nga ne sot duhet të shtojë 14 mijë lekë ekstra për të mbuluar ushqimet apo 16 mijë lekë ekstra për të mbuluar karburantin janë so më poshtë:

Arsyeja e parë është pandemia, një ngjarje, e cila ndodh një herë në 100 vjet, e cila mekanizmin, zinxhirin kërkesë-ofertë e nxori tërësisht nga vendi dhe, derisa kërkesa dhe oferta të balancohen, presionet inflacioniste do të jenë aty; kështu thonë Banka e Shqipërisë dhe bankat qendrore prestigjioze të të gjitha vendeve. Arsyen e dytë të Bankës së Shqipërisë po e citoj: “Në veçanti lufta në Ukrainë është burimi kryesor i pasigurisë.” Është ajo luftë, për të cilën kemi qenë në këtë parlament së bashku, e kemi denoncuar, kemi miratuar rezolutë, e cila e rriti çmimin e grurit 40%, gjë që nuk kishte ndodhur që nga Lufta e Parë Botërore. Pra, në momentin që Putini i vuri tankun dollapit të bukës të Europës dhe të botës, çmimi i grurit u rrit, dhe patjetër që do të ndihet në familjet tona, do të ndihet në familjen e nënës sime, do të ndihet në familjen e prindërve tuaj.

Çështja është çfarë do të bëjmë me të. E keni parë që kjo shumicë vepron, kjo shumicë punon. Që nga ai moment dhe deri sot, ju keni parë paketë pas pakete. E para është subvencionimi i krizës energjetike. Pra, si pasojë e asaj lufte, çmimi i energjisë ka shkuar në nivele që ne nuk i kemi parë në vitet e fundit, madje në dekadat e fundit. Që t'i paguash çdo familjeje shqiptare faturën e energjisë do të thotë të jesh me ta për të kaluar këtë situatë të vështirë, për të kaluar ditët e vështira të dimrit, sepse ne besojmë se kush harxhon më shumë duhet të paguajë më shumë dhe kush harxhon më pak duhet të paguajë më pak. Por edhe në momente të tilla, kur diferencojmë, përsëri monitorojmë, përsëri bashkëbisedojmë, përsëri dëgjojmë.

Prandaj lëvizi fasha mbi 800 kilovat, për të cilën do të debatojmë në një moment tjetër, me sa duket, në varësi të vendimit që do të marrë Konferenca e Kryetareve. Indeksua me 10% pensionet. Patjetër që është e vështirë për pensionistët, por ajo që mund të bëjmë në këtë moment është t'u gjendemi me 10% shtesë të gjithë pensionistëve të Shqipërisë. Rritëm pagat e ushtarakëve, të policëve dhe pagat e bazës më të ulët të administratës shtetërore. Ministria e

Financave nuk është në këtë moment, por jam i sigurt që buxheti që do të vijë do të jetë buxheti që mbron të pambrojturit, mbron më të dobëtit, sepse kjo është Partia Socialiste. Ndërkohë, sfida më e madhe është rritja e ekonomisë.

Banka e Shqipërisë, sot që flasim, thotë që ekonomia ka vazhduar të rritet, patjetër, është ngadalësuar ritmi i rritjes, por ka vazhduar të rritet me 2,2% në 6-mujorin e fundit. Patjetër që duam të shkojmë në 6%, ndaj ju dëgjoni zëvendëskryeministren, edhe Kryeministrin, të cilët janë gjithashtu të kujdesshëm dhe ambiciozë. Si mundet të vazhdojmë me investimet? Si mundet t'i vazhdojmë dhe t'i përfundojmë veprat, që i kemi nisur dhe që u shërbejnë sektorëve strategjikë të ekonomisë sonë, të cilat kanë vazhduar të rriten, si turizmi, bujqësia, ndërtimi e kështu me radhë?

Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë,

Programi i Partisë Socialiste do të jetë puna për të ecur së bashku në këtë shteg të vështirë që kemi përpara, deri sa ekonomia globale, bashkë me të edhe ekonomia jonë, të hyjnë në ujëra të qeta. Ndërkohë, ju do të dëgjoni dhe po dëgjoni një opsion tjetër, që të mblidhemi nëpër sheshe. Ne duam të ecim në shtegun e vështirë të punës, ne duam të ecim në shtegun e vështirë të rimëkëmbjes së ekonomisë shqiptare dhe, siç bëmë me tërmetin, siç bëmë me pandeminë, siç bëmë me krizën energjetike dhe siç do të bëjmë kësaj radhe, do të vazhdojmë të bëjmë edhe në të ardhmen.

Tani, personat që kanë lindur politikisht nëpër sheshe, natyrisht që mund të vendosin ta përfundojnë karrierën nëpër sheshe dhe kjo është një zgjedhje që do ta bëjë çdo shqiptar: do të vazhdojë t'u bashkohet atyre njerëzve, të cilët duan të punojnë për të mbrojtur të sotmen, apo do të vazhdojë të shkojnë te sheshi i shamatës, te sheshi i zhurmës, i cili shumë shpejt mund të kthehet dhe në sheshin e të padëshiruarve. Faleminderit!